8. Për planifikimin e integruar të pellgut lumor dhe analizën e bilanci të ujit, studimi ka shfrytëzuar modelin e simulimit të SVPU-së (Sistemi i Vlerësimit dhe Planifikimit të Ujit), i cili softuer nuk është i patentuar me të drejta të autorit dhe nuk kërkon mbledhjen e sofistikuar të të dhënave. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është e njohur me SVPU-në. Studimi ka dhënë tashmë një bazë të dhënash dhe një bazë për krahasim për ujëmbledhësin e Ibrit dhe zonën e Kosovës qendrore. Studimi ka miratuar edhe përvojën nga një studim i mëhershëm i financuar nga BE-ja në pellgun e lumit Drin. Të marra së bashku, të dy studimet kanë zhvilluar modelet për pellgjet e lumenjve më të mëdha dhe më të rëndësishme në Kosovë. Ky studim ka aplikuar një metodologji sidomos për ndarjen e burimit të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor që është në përputhje me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujë (DKU). Ndërsa qëllimi i kufizuar i këtij studimi natyrisht që nuk mund të sigurojë një plan të plotë menaxhimi të pellgut lumor, i cili plotëson kërkesat e hollësishme të DKU-së, ai ofron një metodologji dhe kornizë në përputhje me kërkesat e direktivës që mund të përsëritet për një analizë më të thellë për këto dy pellgje apo për të mbuluar pellgje të tjera. Megjithatë, asnjë mbledhje fillestare e të dhënave nuk është kryer, por të dhëna ekzistuese megjithatë shumë të shpërndara janë përpunuar dhe vlerësuar për qëndrueshmëri dhe besueshmëri.

9. Planifikimi veçanërisht ka marrë parasysh kërkesat e rrjedhës mjedisore dhe çështjet ndërkuftare, pasi që uji në hidrosistemin e Ibër-Lepencit në thelb merret nga lumi Ibër i cili në drejtim të rrymës nga rezervuari dhe pas përdorimit të tij në Kosovë, kthehet në Serbi dhe derdhet në Moravë, dhe prej andej në Danub. Kërkesat e rrjedhës mjedisore janë vlerësuar në një mënyrë të thjeshtë dhe janë llogaritur "përmendësh" kur bëhet llogaritja e bilanceve ujore. Lumi Ibër buron në Mal të Zi dhe kalon nëpër Serbi, dhe përtej rezervuarit të Gazivodës dhe hidrosistemit të Ibër-Lepencit në Kosovë kthehet në Serbi. Çështjet që lidhen me natyrën ndërkuftare janë diskutuar. Kërkesat për njoftimin paraprak të vendeve bregore në investime të konsiderueshme në lumë janë të komplikuar pasi që Serbia dhe shtetet tjera bregore në drejtim të rrymës së lumit në sistemin Ibër-Morava-Danub nuk e njohin Qeverinë e Kosovës. Këshilla të veçanta juridike do të jenë të nevojshme për çdo masë që kërkon njoftimi. Megjithatë, ekzistojnë precedentë në zonat e ish-Jugosllavisë ku Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Danubit (dhe në raste të tjera por të ngjashme, Komisioni Ndërkombëtar i Savës), kanë vepruar si ndërmjetësues në lehtësimin e komunikimit.

C- Cenueshmëria e furnizimit me ujë të papërpunuar dhe siguria e ujit në Kosovën qendrore

10. Duke marr rajonin e Kosovës qendrore si një njësi hidrologjike dhe ekonomike - mund të dallohen tre lumenj të "pellgut Ibër"- ose nënpellgje, secila me rezervuarin e saj, të cilët janë të lidhur në mënyrë hidrologjike dhe ekonomike. Degët dhe rezervuarët kryesorë janë ilustruar në figurën 1. "Nënpellgu" i kanalit Ibër-Lepenc merr ujin e vet nga rezervuari i Gazivodës. Kanali shkon në jug prej digës së Gazivodës paralelisht me lumin Sitnica, e cila në anën tjetër është një përroskë në pjesën e poshtme të lumit Ibër dhe mbarë rrjedhën e ndotur të kthyer të Kosovës qendrore prapa në Serbi. Kanali për momentin posaçërisht furnizon me ujë hidrocentralin (35 MW), për qytetet e Mitrovicës, Vushtrrisë, dhe disa qytete më të vogla fqinje si dhe dy termocentrale, zonës së zhvillimit industrial përgjatë korridorit Durrës-Prishtinë--Beograd, dhe një pjesë të ujitjes. Gjatë disa viteve të ardhshme, megjithatë, kanali do të furnizojë me ujë të papërpunuar komunën e Prishtinës (duke filluar në vitin 2013), termocentralin e tretë të ri Kosova e Re (pas vitit 2014), si dhe zgjerimin e pritshëm të konsiderueshëm të zonave të ujitura. Kështu, ky

nënpellg i lumit përfshin qytetet kryesore dhe aktivitetet kryesore ekonomike të Kosovës.

11. Nën-pellgje të Llapit dhe Graçanicës funksionojnë respektivisht me rezervuarët e Batllavës dhe Badovcit, dhe aktualisht të dyja bëjnë furnizimin e Kompanisë Rajonale të Ujit në Prishtinë me ujë për popullatën e Prishtinës dhe komunitete të vogla në lagje të kryeqytetit. Kjo situatë ka pak gjasa që të ndryshojë në të ardhmen pasi që kapaciteti maksimal i furnizimit të këtyre ujëmbledhësve është arritur tashmë dhe rezervuarët kanë më tepër të ngjarë të pësojnë rënie të kapaciteteve në të ardhmen për shkak të shfrytëzimit të zgjeruar dhe të parregulluar të tokës dhe presionit të rritur të ndotjes.




Figura 1: "Pellgu lumor" i Ibrit në Kosovën qendrore dhe veriore

12. Shqetësimi i sigurisë së ujit në pellgun e Ibrit i referohet tri dimensioneve:

- Aftësisë aktuale të burimeve të ujit dhe infrastrukturës së rezervuarit për të siguruar një furnizim të besueshëm me ujë, për të përmbushur të gjitha kërkesat, në kushtet aktuale (2010);
- Aftësisë së burimeve të ujit dhe infrastrukturës së rezervuarit për të siguruar furnizim të besueshëm me ujë gjatë dekadave të ardhshme, deri në vitin 2020 dhe 2035, nën kushte të

vitit të thatë dhe shumë të thatë, duke marrë parasysh skenarë të mundshëm të ndryshimeve klimatike, por edhe rritjet në popullatë, aktivitetet në bujqësi dhe industri; dhe

- Aftësisë së infrastrukturës fizike në formën e rezervuarëve dhe sistemet e bartjes së ujit për ta bërë këtë në një mënyrë të besueshme.




Figura 2: Ndërlidhja grafike e SVPU-së duke paraqitur lokacionet e resurseve dhe kërkesave sipas modelit

13. Siguria e ujit të papërpunuar, siç është marr në këtë studim, nuk është e kufizuar me çështjen e mungesës absolute të burimeve të ujit. Përkundrazi, ajo i referohet brishtësisë së përgjithshme dhe (mungesës) së besueshmërisë dhe fuqisë së sistemeve natyrore dhe fizike të furnizimit me ujë, sipas skenarëve të ndryshëm, ku në të njëjtën kohë bëhet zvogëlimi i kapaciteteve të furnizimit me ujë dhe rritja e kërkesës. Në kuadër të kushteve aktuale të mesatares vjetore (për vitin bazë 2010), dy lokacione të deponimit të ujit në pellgun e Gazivodës dhe Batllavës kanë aftësi të mjaftueshme për furnizim me ujë për të plotësuar kërkesat gjatë gjithë vitit. Modeli simulim i SVPU është aplikuar për të studiuar mospërputhjen në mes të sasive të furnizimit me ujë dhe kërkesës për ujë, duke përdorur nyje të burimeve dhe kërkesës, siç përshkruhen në figurën 2. Rezultatet e simulimit janë paraqitur në figurat 3, 4 dhe 5, për secilën nga tre rezervuarët. Bilanci i ujit (furnizimi dhe kërkesa) është paraqitur çdo herë në mënyrë akumulative gjatë vitit. Linja (e verdhë) tregon rrezikun: nënkupton prurjen akumulative në një vit shumë të thatë, që është marrë këtu në një përqindje përfaqësuese prej 50% të prurjes së vitit bazë. **Rezervuari i Gazivodës** ka kapacitet të mjaftueshëm rezervë, megjithatë, duhet vënë re se kërkesa për ujë sipas vitit 2010 është ende në shkurtim të ashpër në të gjithë sektorët, dhe gjatë 5-10 viteve të ardhshme do të shoh një rritje të dukshme, që në këtë fazë nuk është e mundur të përcaktohet më saktë. Gjithashtu, kanali i Ibër-Lepencit për momentin nuk është në gjendje që të realizojë këtë potencial pasi që është i kufizuar në kapacitetin e bartjes. **Rezervuari i Batllavës** në mënyrë të ngjashme ka ende një kapacitet rezervë në dispozicion; megjithatë, në kushte të një viti shumë të thatë, ekziston rreziku i qartë se niveli i ujit në rezervuar do të bjerë shumë nën nivelin e normales (siç sugjerohet në aspektin kualitativ nga vija e verdhë në figurën që paraqet 50% të prurjes më të ulët sesa mesatare); dy vjet të thata radhazi do të çojnë në situata emergjente. Përveç kësaj, është ujëmbledhësi ai që është më i pambrojtur ndaj presioneve për shkak të ndryshimeve në përdorimin e tokës si dhe ndotjes në rritje. **Rezervuari i Badovcit** nën kushtet aktuale nuk ofron burime të mjaftueshme të ujit për të plotësuar kërkesën prej 35% të qytetit të Prishtinës madje edhe në kushte të të reshurave mesatare (kolona me të kuqe - kërkesa - në mënyrë sistematike tejkalojnë larg kolonat e kaltra të prurjes).




Figura 3: Bilanci i ujit i rezervuarit të Gazivodës (për vitin bazë 2010)




Figura 4: Bilanci i ujit i rezervuarit të Batllavës (për vitin bazë 2010)




Figura 5: Bilanci i ujit i rezervuarit të Badovcit (për vitin bazë 2010)

14. Prandaj, pellgu i Ibrit në përgjithësi mund të pritet që të ketë mundësinë e mjaftueshme të ujit në shumicën e kohërave kyçe të kërkesës për ujë gjatë tërë vitit në kushtet aktuale. Megjithatë, në të ardhmen e afërt dhe në bazë të supozimeve të ndryshimeve klimatike të pafavorshme dhe rritjes së madhe në kërkesën urbane, industriale dhe bujqësore për ujë, skenari i SVPU tregon se burimet e ujit nuk do të balancojnë kërkesën brenda vitit, Struktura e kërkesës mund të zhvendoset gradualisht, dhe besueshmëria në periudhën afatmesme e Batllavës dhe sidomos e ujërave nëntokësore lokale ka gjasa të ulet.

15. Rezervuari i Badovcit nën kushtet aktuale është tashmë në një situatë kritike dhe duhet të rishikohet me kujdes më tej. Çdo rritje e kërkesës drejtuar rezervuarit të Badovcit ka të ngjarë të kalojë në burim të Gazivodës.

16. Studimi vlerësoi integritetin strukturor dhe cilësinë ndërtimore të sistemeve të bartjes së ujit të papërpunuar, në veçanti të kanalit Ibër-Lepenc. Kjo infrastrukturë ka nevojë për rehabilitim, si dhe mbrojtjen kundër bllokimeve të rastësishme, ndotjes dhe shkaqeve të tjera të pengimit. Humbjet e ujit janë të konsiderueshme në sistemet aktuale të bartjes, dhe disa pika të nxeha të humbjeve të ujit janë riparuar me kosto relativisht të ulët. Humbjet e tjera të mëdha mund të riparohen në mënyrë të ngjashme, por reduktimi i humbjeve shtesë mund të jetë i kushtueshëm pasi që do të jetë e nevojshme që të riparohet vija e kanalit në një gjatësi të madhe. Përveç kësaj, rrëshqitjet e baltës, mbeturinave dhe, herë pas here, kafshëve që përfundojnë në kanal in e pambrojtur të Ibër-Lepencit, si dhe rrëshqitjet e ndotura nga fushat dhe rrugët përreth, të gjitha rrezikojnë si besueshmërinë, ashtu edhe cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë të papërpunuar. Ndotja bakteriologjike dhe kimike, si dhe mbeturinat janë gjithashtu duke ndikuar gjithnjë e më shumë në cilësinë e duhur të ujit, që është një shqetësim në rritje, pasi që të tria burimet e ujit së shpejti do të përdoren në mënyrë intensive për furnizimin komunal me ujë të pijshëm. Një raport i veçantë¹ ka vlerësuar sigurinë e digave dhe duke u bazuar në rekomandimet e tij ky studim nuk ka adresuar këtë çështje.

17. Sistemet komunale dhe sistemet industriale kyç të furnizimit me ujë janë për momentin të furnizuara përmes tubacioneve dhe sistemeve të kanaleve individuale, të cilat janë shpesh përtej jetëgjatësisë së tyre ekonomike, apo në nevojë urgjente për rehabilitim dhe modernizim. Puna e rehabilitimit ka filluar. Në mënyrë që të zvogëlohet brishtësia e tyre gjatë furnizimit pa pengesa, venddeponimet shtesë duhet të ndërtohen dhe këto sisteme duhet të jenë të ndërlidhura më mirë për të kapërcyer periudha kritike të furnizimit. Për momentin, furnizimi me ujë në qytetet kryesore është i brishtë pasi që furnizimet nuk janë nga pikat e ndryshme. Me shterjen e shpejtë të furnizimit të Prishtinës me ujë (që nga 2014) nga kanali Ibër-Lepenc për herë të parë, qyteti do të marrë një hap për të diversifikuar varësinë e tij aktuale nga rezervuarët e Batllavës dhe Badovcit. Në mënyrë të ngjashme, do të ishte mirë të ekzistojnë kapacitete shtesë të grumbullimit përgjatë kanalit Ibër-Lepenc që të sigurohen sasia për furnizim me ujë në rrethana ekstreme për termocentralin e ri dhe më të madh, Kosova e Re, si dhe termocentralin e rinovuar Kosova B.

18. Tendenca drejt rritjes së ndotjes së ujërave nëntokësorë duhet të eliminohet. Ujërat nëntokësorë janë gjithnjë e më të ndotur. Nëntëdhjetë për qind e qytetit dhe popullsisë rurale pa qasje në një rrjet ujësjellësi për ujë të pijshëm dhe gatim varen nga pusët e cekëta apo gropat e hapura në tokë. Ndotja e ujërave nëntokësore është në rritje për shkak të ritmit të shpejtë të urbanizimit në tokë përreth qyteteve dhe shfaqjes së objekteve të vogla industriale në mungesë të mekanizmave efektive për parandalimin e ndotjes. Për të arritur objektivin e furnizimit të sigurt me ujë, sistemet e gypave të furnizimit me ujë duhet të zgjerohen më tej për të rritur numrin e popullatës të lidhur në sistemin e ujësjellësit, si dhe masat duhet të merren në drejtim të kontrollit të ndotjes së ujërave nëntokësorë. Politikat e tilla duhet të zhvillohen në një strategji të menaxhimit të integruar të ujit për pellgun, e cila duhet të jetë në përputhje me KDU të BE-së.

¹ Projekti i rehabilitimit të ujit në Kosovë – Komponenti i sigurisë së digës 2004, në kuadër të mbështetjes së BE-së, të realizuar nga konsulentët e DHV-së. Raporti vlerëson sigurinë strukturore të 5 digave (Gazivodë, Batllavë, Badovc, Radoniq dhe Prilepnicë) dhe konkludon se ndërtimi i tyre relativisht i ri dhe standardet e mira të ndërtimit kanë parandaluar paraqitjen e emergjencave të mëdha deri më tani. Sidoqoftë, po paraqiten çështjet e sigurisë në të gjitha digat (tubacionet, të fryra, amortizimi etj.) si dhe shqetësimet janë duke u paraqitur lidhur me përshtatshmërinë e drejtimit të derdhjes së ujit dhe procedurave emergjente. Raporti e pranon se riparimi ende nuk është një prioritet i nivelit të lartë por rekomandon kujdes dhe një përcjellje më të thuktë, me një kosto të vlerësuar prej 1 milion euro).

19. Cilësia e ujërave të përdorura dhe të kthyer që mbledhen në lumin Sitnica është shumë e dobët. Kjo paraqet potencialisht një rrezik për shëndetin e njeriut në nivel lokal, dhe mund të bëhet një burim i konfliktit me shtetet ku kalon lumi (Serbia).

20. Gjatë dy dekadave të ardhshme kërkesa do të rritet, ndërsa **ndryshimi i klimës dhe ndryshueshmëria** ka të ngjarë të zvogëlojë reshjet atmosferike. Kështu, sistemi mund të ballafaqohet me mungesa. Me përdorimin e modelit të SVPU, janë zhvilluar një numër i skenarëve për periudhën deri në vitin 2035. Çdo skenar merr në mënyrë progresive më shumë faktorë në konsideratë në mënyrë që të testohet brishtësia e sistemit. Pasi që sistemet e rezervuarëve nuk janë të ndërlidhur për momentin, nevojat për ujë dhe disponueshmëria janë llogaritur për çdo rezervuar veç e veç. Skenari 1 merr parasysh vetëm rritjet e nevojave të ujit për konsumin e njeriut. Skenari 2 përveç kësaj merr parasysh rritjet nevojave të ujitjes. Sistemi ekzistues i ujitjes (kryesisht në gjendje të keqe) ishte projektuar fillimisht për 19.000 hektarë, do të mund t'i shërbente 8000 hektarëve, por në vitin 2010 vetëm 1000 hektarë janë ujitur në të vërtetë. Skenari 2 supozon se 10.000 hektarë gjithsej do të ujitin në pellgun Ibër deri në vitin 2035. Skenari 3 shton kërkesat e industrisë dhe minierave, si dhe kërkesën e rritur të konsumit që rezulton nga qëllimet e ftohjes (nga të cilat pjesa më e madhe është jokonsumuese). Skenari 4 shikon se si skenari 3 do të përballen në një vit të thatë në kushte historike meteorologjike. Së fundi, Skenari 5 analizon rrezikun që rrjedh nga vitet e thata duke u bërë edhe me i thatë si pasojë e ndryshimeve klimatike johistorike. Skenari 4 ilustron për rezervuarin e Gazivodës (Fig. 5).




Figura 6: Bilanci i ujit të Gazivodës në vitin 2035 duke supozuar kërkesën e shtuar nga të gjithë sektorët dhe sipas kushteve historike të vitit të thatë (p.sh. sipas kushteve historike meteorologjike pa ndryshime klimatike)

21. Mungesa e burimeve të ujit ka gjithnjë e më shumë gjasa të ndodh në vitet e ardhshme të thata në qoftë se nuk merret asnjë veprim përshtatës. Siç ilustron figura 6 për digën e Gazivodës, që ka kapacitetin më të madh rezervë të furnizimit me ujë të papërpunuar për momentin, mungesat në vitet e thata do të ndodhin gjatë ose rreth vitit 2035, sidomos në muajt prill deri gusht gjatë sezonit të ujitjes. Sidoqoftë, për rezervuare të Badovcit dhe Batllavës, mungesa strukturore në vitet e thata me siguri do të fillon të ndodh që para vitit 2010, dhe përkatësisht nga viti 2020. Duhet të theksohet se këto simulime për rezervuarin e Gazivodës supozojnë se kërkesat e paplotësuara për rezervuarët e Badovcit dhe Batllavës nga zonat jugore dhe lindore të Prishtinës nuk do të

zhvendoseshin në sistemin e kanalit të Gazivodës/lbër-Lepencit. As që këto simulime parashikojnë që presionet në rritje të tokës dhe ndotjes në këto rezervuare në të vërtetë mund të zvogëlojnë kapacitetin e tyre të furnizimit. Është e mundshme megjithatë, që gjatë dy dekadave të ardhshme një kërkesë në rritje nga kjo pjesë e pellgut do të zhvendoset në mënyrë efektive tek kanali i Gazivodës/lbër-Lepencit, e cila do të çonte këtë sistem në mënyrë të pakthyeshme në përmbushjen maksimale të kapacitetit të vet furnizues diku midis viteve 2020 dhe 2030. Tabela 1 përmbledh rezultatet e arritura në kuadër të zhvillimit të modelit të SVPU.

Tabela 1: Analiza e rezultateve të SVPU-së duke treguar nivelet e rrezikut sipas 5 skenarëve

Sistemi	Skenari	Deri në vitin 2020	Deri në vitin 2035
Sistemi 1 – Sistemi i Gazivodës	Skenari 1	Green	Yellow
	Skenari 2	Green	Yellow
	Skenari 3	Green	Red
	Skenari 4	Green	Red
	Skenari i rastit më të keq	Green	Red
Sistemi 2 – Sistemi i Batllavës	Skenari 1	Green	Red
	Skenari 2	Diagonal	Diagonal
	Skenari 3	Diagonal	Diagonal
	Skenari 4	Green	Green
	Skenari i rastit më të keq	Green	Red
Sistemi 2 – Sistemi i Badovcit	Skenari 1	Red	Red
	Skenari 2	Diagonal	Diagonal
	Skenari 3	Diagonal	Diagonal
	Skenari 4	Red	Red
	Skenari i rastit më të keq	Red	Red
Sistemi 3 – Sistemi i ujërave nëntokësor	Skenari 1	Green	Green
	Skenari 2	Green	Green
	Skenari 3	Green	Green
	Skenari 4	Red	Red
	Skenari i rastit më të keq	Red	Red



Furnizimi i ujit të papërpunuar është më i vogël se kërkesa, por ekziston rreziku i mungesave të rastësishme – duhet të përqaqiten masat.

Siguria e ujit është e garantuar, por është e kufizuar – duhet të iniciohet zbatimi i masave përshtatëse.

Kërkesa e tejkalon furnizimin – masat e kursimit të ujit janë thelbësore

Nuk është e zbatueshme

22. **Në përfundim**, kapaciteti i burimeve ekzistuese të ujit, p.sh. rezervuarëve dhe ujërave nëntokësor për të kënaqur kërkesën aktuale dhe kërkesën në të ardhmen e afërt (2013-2017) është i mjaftueshëm për dy rezervuarët dhe i pamjaftueshëm për atë pjesë të qytetit të Prishtinës që është i furnizuar nga rezervuari i Badovcit. Megjithatë, në periudhën afatshkurtër, shqetësimi kryesor në lidhje me brishtësinë e sistemit, dhe sigurinë e furnizimit me ujë, i referohet gjendjes së dobët të strukturave të transportit, mungesa e kapacitetit ujëmbledhës për të kapërcyer mungesën e përkohshme, mungesës së ndërlidhjeve të zonave të ndryshme të kërkesës në pellg, si dhe mungesës së një mekanizmi të planifikimit për të identifikuar prioritetet për investime dhe shpërndarjen e ujit për përdoruesit e ndryshëm të ujit të transportuar të papërpunuar.

D- Masat dhe investimet prioritare

23. **Në përgjigje të kësaj dobësie, studimi ka identifikuar masat prioritare strukturore dhe jostrukturore** dhe ka identifikuar një numër të koncepteve investive dhe të politikave, të cilat do të kërkojnë një analizë të mëtejme. Masat strukturore në një periudhë të menjëhershme afatshkurtër përfshijnë: (i) zvogëlimin e humbjeve në sistemet e transportimit të ujit të papërpunuar, (ii) krijimin e ndërlidhjeve për transferimin e ujit në mes të sistemeve/zonave të ndryshme në pellgun e Ibrit, dhe (iii) mbrojtjen e kanalit të Ibër-Lepencit kundër bllokimeve, ndotjes dhe llojeve të tjera të pengesave. Masat jostrukturore përfshijnë: (i) masat e mbrojtjes për zonat ujëmbledhëse (politikat, monitorimi, zbatimi i rregullave, kapaciteti administrativ dhe trajnimi i stafit, etj), (ii) monitorimi i zgjeruar dhe grumbullimi i të dhënave në mënyrë të veçantë për ujërat nëntokësorë, dhe (iii) monitorimi i zgjeruar dhe mbledhja e të dhënave për qëllime hidrologjike në përgjithësi.

24. Për një periudhë më afatgjatë, krijimi i furnizimit shtesë me ujë dhe deponimit të ujit do të duhet të shqyrtohet. (Kjo mund të jetë nga një sistem i zgjeruar i Gazivodës/Ibrit; ndërtimi i rezervuarit të ri në Lepenc, në jug me kanal in për bartje deri te Kosova qendrore²; dhe një sistem bartjeje, me mundësi të përfshirjes së ujërave të thella nëntokësore, nga ana perëndimore e vendit). Zëvendësimi i kanalit ekzistues të hapur për përcjelljen e ujit të pastër nga rezervuari i Gazivodës përmes një gypi nën presion për reduktimin e humbjeve është gjithashtu një mundësi. Reduktimi i konsumit për kokë banori duhet të inkurajohet. Duhet përkujtuar se nuk është e sigurt se ujitja do të zgjerohet për 10.000 ha dhe se ujitja pikë-pikë mund të zvogëlojë konsumin e përgjithshëm të ujit.

25. **Masat janë vënë në pako dhe u janë caktuar prioritete duke përdorur disa kritere.** Janë bërë analiza paraprake ekonomike të pakove prioritare. Masat janë marrë në shqyrtim dhe janë vlerësuar duke përdorur një qasje

² Banka Botërore ka këshilluar qeverinë përmes këtij aktiviteti të njëjtë Këshillëdhënës që planet e vitit 1980 për rezervuarët e Lepenci nuk janë më reale. Por, një lokacion alternativ për rezervuar dhe sistem transporti janë identifikuar, kostot e tyre janë përtej mundësive të shtetit në këtë moment (*Kosova—drejtë planit strategjik të veprimit për ujë: Vlerësimi i kërkesës dhe furnizimit me ujë, si dhe realizueshmëria e Skemës së Ibër-Lepencit jugor*, Banka Botërore, nëntor 2009.

të shumë kriterëve. Çdo masë është analizuar në lidhje me: angazhimin e palëve të interesuara, ndikimin në mjedis, pasojat ndërkufitare, ndikimin e zhvillimit ekonomik dhe efekteve të menjëhershme të punësimit, kompleksitetin teknik, fleksibilitetin dhe gatishmërinë. Janë identifikuar katër pako të projekteve prioritare. Pakoja e parë tashmë është në realizim e sipër dhe është përmendur për shkak të tërësisë. Për secilën pako janë identifikuar komponentët dhe një analizë e rentabilitetit, si dhe është realizuar llogaritja bazuar në VAN (vlera aktuale neto). Megjithatë, analiza ka treguar se shumica e këtyre masave mund të konsiderohen si masa "për mos pendim", pasi që ato duhet të ndërmerren pavarësisht nga skenarët e ndryshëm zhvillimor, dhe për të adresuar situatat që së shpejti do të marrin formë emergjente për shkak të gjendjes së dobët të infrastrukturës dhe kërkesave në rritje kundrejt furnizimit të stagnuar.

26. **Pritet të fillojë në vitin 2012 projekti për përmirësimin e lidhjes për Prishtinën dhe përmirësimin e besueshmërisë së furnizimit me ujë.** Projekti është zhvilluar nga Kompania Rajonale e Ujit në Prishtinë me financimin e KfW. Ky projekt do të marr një pjesë të furnizimit me ujë të Prishtinës nga kanali i Ibër-Lepencit, duke e bërë kështu furnizimin e Prishtinës me ujë më pak të rrezikuar (më të sigurt). Në të njëjtën kohë, ky investim do të rrisë më tej rëndësinë e sigurisë së furnizimit të pandërprerë me ujë nga kanali Ibër-Lepenc, si dhe marrjen e masave parandaluese për të minimizuar mundësitë për ndotjen e ujit të kanalit.

27. **Pako e projektit për të siguruar furnizim të pandërprerë me ujë të kualitetit të mirë nga kanali i Ibër-Lepencit (kostoja vlerësohet deri në 31 milionë euro).** Kjo pako përfshin këto masa të investimit: (i) riparimin e kanalit (murosje me gur, mbajtëset, themelet, prerjet, nënkalesë ujërash, etj) dhe mbrojtja kundër dëmtimeve të përtërira fizike nga rrëshqitjet e tokës, toka të paqëndrueshme, dhe pengesa të shkaktuara nga njeriu, (ii) deponimi afatshkurtër përgjatë kanalit për të mbuluar kërkesën e pikut të ujit dhe ndërprerjet e përkohshme për qëllime riparimi, (iii) mbrojtja e kanalit kundër ndotjes së përsëritur, ndotjes aksidentale dhe rreziqeve e ndërprerjeve të tjera, nëpërmjet ndërhyrjeve të tilla si vendosja e gardhit dhe mbulimi, (iv) pajisje për menaxhimin më të mirë të portave dhe rregullimi i rrjedhës së ujit, (v) krijimi i një platforme të palëve të interesuar për një dialog mbi rregullat e ndarjes, (vi) Mbështetje për vendosjen e rregullave për shpërndarjen e ujit dhe caktimin e prioriteteve në mes kërkesave konkurruese, dhe (vii) ngritja e kapaciteteve për kompaninë e hidrosistemit Ibër-Lepenc për këto çështje, si dhe trajnimin se si duhet vepruar në situata emergjente. Kostoja gjithsej është vlerësuar në rreth 31 milionë euro. Raporti në mes përfitimit dhe koston është më i lartë se 1.1. Komponenti më i madh i koston është riparimi i skajeve të kanalit të propozuar prej 25 kilometrave, në një kosto të vlerësuar prej 25 milionë euro për një rinovim të plotë që mund të konsiderohet e tepruar. Megjithatë, kjo mundësi ende mund të ofrojë përfitime në afat të gjatë pasi që sasia e ujit në dispozicion do të ishte më e madhe. Gjatësia, kostoja e propozuar dhe specifikat e tjera do të duhet të testoheshin dhe të vlerësoheshin në një studim fizibiliteti. Me një buxhet të caktuar në dispozicion, një detyrë kyçe për studimin e fizibilitetit do të ishte për të identifikuar pjesët që kanë nevojë më urgjente për murosjen e kanalit.

28. **Pakaja për pilot zhvillim dhe mbrojtje të njohurive për ujërat nëntokësor (e vlerësuar në 1.4 milion euro).** Kjo pako përfshin këto masa të investimit: (i) përshkrimin e karakteristikave dhe identifikimin e presioneve të mëdha në (pilot) trupa të ujërave nëntokësorë, (ii) instalimin e rrjeteve të monitorimit të ujërave nëntokësorë, dhe (iii) mbështetje për fermerët për vendosjen e masave fizike për mbrojtjen e furnizimit të ujit të pijshëm. Koston gjithsej të investimeve janë vlerësuar në rreth 1.4 milion euro, dhe raporti ndërmjet përfitimit dhe koston do të jetë mbi 3. Projekti është një pilot projekt, që trajton çështjen kyçe të mbrojtjes së ujërave nëntokësorë në pellgun e Ibrit. Mbrojtja e ujërave nëntokësorë është veçanërisht e rëndësishme për popullsinë rurale që nuk është e lidhur me furnizimin e centralizuar të ujit përmes ujësjellësit.

29. **Pako e projektit për mbrojtjen e rezervuarëve të ujit të pijshëm (vlerësuar në 12 milionë euro).** Kjo pako do të përfshinte masat vijuese të investimeve: (i) përgatitjen e një plani të mbrojtjes për secilën nga tre rezervuarët në përputhje me Direktivën e BE-së për ujin e pijshëm, (ii) pajisje për monitorimin e hidrologjisë dhe cilësisë së ujit, (iii) Ngritja e kapaciteteve të stafit, (iv) objektet sanitare për objektet rekreative në rezervuare, (v) cisterna septike dhe drenazhi i ujërave të zeza për vendbanimet rurale (dendësi e ulët), fermat dhe bizneset që nuk planifikojnë të lidhen me sistemin e centralizuar të drenazhit dhe ujërave të zeza, dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme, (vi) blerja e tokës në zonat e mbledhjes së përroskave. Kostot gjithsej të investimeve janë vlerësuar të jenë rreth 12 milionë euro (përfshirë blerjet e tokës) dhe një raport ndërmjet përfitimit dhe koston në përafërsisht 2.

E- Konkludimi

30. Studimi ka dokumentuar rëndësinë e investimit në sigurinë e ujit në Kosovën qendrore dhe ka identifikuar masat prioritare për periudhën afatshkurtër brenda një periudhe planifikimi prej 3-6 vjet. Studimi do të duhet të plotësohet me analiza më të thella, veçanërisht për të konfirmuar se masat e propozuara janë me të vërtetë opsioni më i mirë dhe më kostoefektivë për të trajtuar mungesën në rritje të sigurisë së furnizimit. Megjithatë, masat e propozuara kanë gjasa thelbësore për të reduktuar brishtësinë e zemrës ekonomike të Kosovës në mungesën e ujit në vitet e thata për shkak të ndërprerjes në furnizim dhe ndotjes, si dhe ndryshimeve klimatike që do të përkeqësonin ndjeshëm bilancin e ujit pas vitit 2020.